



## Plani i Punës së Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë për 2011

### I. Strategjia e AKK-së për periudhën 2011-2015

Vizioni dhe misioni i AKK-së i përcaktuar në Strategjinë për periudhën 2011-2015 (të aprovuar nga Bordi i AKK-së) sheh AKK-në në vitin 2015 si organizatë më të fuqishme dhe më efektive në:

1. Avokim në emër të komunave tek niveli qendror, dhe
2. Shërbim të nevojave të komunave anëtare

Me realizim të këtij vizioni dhe misioni do të dëshmohet dobishmëria dhe këmbëngulësia e AKK-së, dhe pritet që komunat do të paguajnë anëtarësinë në tërësi dhe kështu të sigurojnë qëndrueshmërinë financiare të AKK-së.

Rezultatet e pritura nga katër fushat strategjike të veprimit për realizim të vizionit dhe misionit janë:

#### 1. Avokim dhe lobim pro-aktiv

- Interesat e komunave janë promovuar dhe mbrojtur tek qeveria qendrore, agjensionet ndërkombëtare dhe institucionet tjera relevante
- Aktivitetet lobuese janë koordinuar në mënyrë efektive për t'i mundësuar komunave të flasin njëzëri
- Legjislacioni që afekton kompetencat komunale është harmonizuar dhe shërben interesat e komunave

#### 2. Zhvillim efektiv i kapaciteteve

- Koncepti afatgjatë dhe i bazuar në nevoja për zhvillim të kapaciteteve dhe trajnime për komuna është zhvilluar gradualisht dhe është duke u zbatuar
- Trajnim kualitativ i ofruar bazuar në kërkesa specifike të komunave

#### 3. Përmirësim në ofrim të shërbimeve

- Funkionim efektiv i brendshëm i administratave komunale është përkrahur përmes harmonizimit të strategjive, akteve, organizimit si dhe procedurave relevante komunale të cilat shërbejnë qytetarët dhe sektorin privat
- Ofrim i ekspertizës së kualifikuar teknike dhe ligjore në fushat ku komunat dhe Kolegjiut nuk kanë ekspertizë të tillë
- Ofrim i shërbimeve specifike komunave të reja që nxisin integrimin
- Ofrim i këshillave të kualifikuara dhe lobim efektiv për financim nga palët e treta

#### 4. Efiçenca organizative

- Në vitin 2015, AKK është një organizatë kompetente, e përparuar dhe financiarisht e qëndrueshme, me leverdi substanciale në procesin e decentralizimit

- Bordi dhe Këshilli i Kryetarëve ofrojnë udhëzime strategjike
- AKK, kryesisht përmes "Miqëve të AKK-së", mirëmban marrëdhënie të shkëlqyera me komunitetin e donatorëve ndërkombëtarë

## II. Prioritetet e identifikuara në Deklaratën Parimore për Arsim dhe Kulturë

### Infrastruktura

1. Rritje të qëndrueshme të burimeve financiare në sektorin e arsimit në Kosovë.
2. Është e rëndësishme që të gjitha palët; qytetarët, komunat, qeveria e Kosovës dhe donatorët të kenë konsideratë për këtë çështje.

Masat e nevojshme që duhet të ndërmerren janë:

1. Angazhimi i të gjithë aktorëve përgjegjës për qeverisjen në Kosovë duke u bazuar në caktimin e prioriteteve,
2. Shqyrtimet e veçanta për ndërtimin e hapësirave për njerëzit me aftësi të kufizuara me qëllim të ofrimit qasje të përshtatshme në sistemin arsimor,
3. Përcaktimi i afateve për përmirësimin e infrastrukturës arsimore

### Menaxhimi i Shkollave

1. Kërkohej përkrahje nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Institucionet tjera relevante për të ndihmuar me projekte konkrete në këtë çështje.
2. Kërkohej nga komuniteti arsimor edhe pse një gjë e tillë është pak e vështirë që t'i përtërijnë përpjekjet për zgjidhjen e problemeve të përditshme me të cilat po ballafaqohemi, duke aktivizuar më shumë këshillat e shkollave, komitetet për arsim dhe aktorët e tjerë që mund të ndihmojnë në këtë çështje.

### Zhvillimi profesional

Bashkëpunimi mes DKA-së dhe MASHT-it në zhvillimin profesional në sferën e arsimit është shumë i rëndësishëm. Për këtë çështje komunat kërkojnë:

1. Një proces të qartë me anë të të cilit personeli komunal dhe ai mësimdhënës do të përfshihen në zhvillimin e plan-programeve në mënyrë publike dhe transparente.
2. Rishikimi i plan-programeve ekzistuese është e mirë që edhe komunat janë të kyçura në të,
3. Liria e komunave për të vendosur 20 % të plan-programit të lejuar për t'u hartuar nga komunat.
4. Personeli komunal dhe ai mësimdhënës të përfshihen në vlerësimin e teksteve shkollore të propozuara për përdorim në shkolla
5. Procesi i trajnimit të stafit mësimdhënës dhe personelit - zyrtarëve arsimorë të jetë më i madh.
6. Të mundësohet procesi i pjesëmarrjes së arsimtarëve në trajnime dhe të mundësohet mbajtja e mësimi shtesë për ata që zëvendësojnë ose kryesisht trajnimet të organizohen vikendeve dhe gjatë pushimeve.

## III. Prioritetet e Kolegjiumit për Arsim dhe Kulturë për vitin e kaluar (2010)

1. Përmirësimi i cilësisë në arsimin para-universitar
2. Të unifikohet implementim i akteve ligjore dhe nënligjore
3. Të ngritet kapaciteti i komunave për menaxhim dhe udhëheqje në arsim
4. Të hartohen planet zhvillimore strategjike në arsimin komunal për periudhën trevjeçare
5. Analizimi i gjendjes në arsim dhe rekomandimet e konkluzionet për institucionet vendimmarrëse;
6. Unifikimi i qëndrimeve për çështje të caktuara;
7. Këmbimi i përvojave mes komunave dhe vendeve në rajon dhe përmes vizitave studimore e trajnimeve;

8. Ofrimi i programeve trajnuese për zyrtarët e Drejtorive Komunale për Arsim dhe përgjegjësve të shkollave për vetë-menaxhimin financiar të shkollës

#### **IV. Çështjet e ngritura në takimin e Kolegjiutit me 04 shkurt 2011**

Kolegjiutit për Arsim dhe Kulturë mund të jap ndihmën e vet duke:

1. Ndihtuar në elaborimin e profileve arsimore, profilet mund të përcaktojnë detaje për ngritjen e cilësisë në arsim, duke krijuar edhe një ambient më të përshtatshëm për arsim:
2. Duke planifikuar dhe zbatuar projekte ndër-komunale për arsimin
3. Duke ndihmuar në përfundimin e bashkëpunimit mes komunave dhe ministrive të ndryshme të përfshira në proces.
4. Kolegjiutit të bëjë rekomandime për ndryshim të Udhëzimit Administrativ të MASHT, në mënyrë që të forcohen masat disiplinore për nxënësit problematik
5. Të nxirret një Rregullore apo Kod i Mirësjelljes për mësuesin dhe të sanksionohen mungesat e mësuesve
6. Të rregullohet çështja e orëve private përmes akteve adekuate
7. MASHT të shpërndajë udhëzimet për konkurset e pranimit të nxënësve në shkolla të mesme individualisht për çdo komunë
8. Kolegjiutit të informoj me shkrim qëndrimet dhe informatat tjera relevante tek të gjithë pjesëmarrësit
9. Kryesia e Kolegjiutit së bashku me AKK të përpiloj Planin e Punës për vitin 2011
10. Kolegjiutit të prezantoi në takimin e radhës një raport më detaj rreth punës gjatë vitit 2010 me konkluzat/rekomandimet dhe realizueshmërinë e tyre (sa prej tyre kanë pasur sukses e sa jo)
11. DAK-të të monitorojnë zbatimin e kriterëve për regjistrimin e nxënësve nëpër gjimnaze
12. DAK-të të fuqizojnë bordet e shkollave dhe të shqyrtohet mundësia për futjen e përfaqësuesve të biznesit në këto borde, sipas përvojës së mirë të Komunës së Suharekës. AKK të lehtësoj procesin e ndarjes së kësaj përvoje me të gjitha komunat tjera
13. DKA-të të përcaktojnë listat e administruesve dhe vëzhguesve të përgjegjshëm dhe ndërgjegjshëm
14. Komunat të fuqizojnë zyrat e inspektoratit dhe të bëhen hospitime më të shpeshta gjatë orarit të mësimit në mënyrë që të shtohet kontrolli i punës
15. DAK-të të obligojnë Drejtorët e shkollave të vlerësojnë punën e mësuesve dhe të raportojnë në Bordin e Drejtorëve të Komunës. Poashtu të shqyrtohet mundësia e vlerësimit të mësuesve edhe nga nxënësit
16. DAK-të të kërkojnë nga shkollat përzgjedhjen e nxënësve talent dhe atyre me nevoja të veçanta dhe lista t'i drejtohet MASHT-it
17. MASHT së bashku me komunat të ndërtoj një sistemi efikas të menaxhimit cilësor të provimit të maturës
18. MASHT të publikoj rezultatet e testit të klasës V
19. MASHT të trajnoj mësuesin për vlerësim

#### **V. Plani Vjetor i Punës për vitin 2011**

Plani Vjetor i Kolegjiutit për vitin 2011 ka për qëllim të:

- organizoj punën e Kolegjiutit
- bashkërendoj idetë dhe lehtësoj/udhëheq zbatimin e aktiviteteve

- arrijen e objektivave të Kolegjiumit dhe AKK-së, dhe
- kontribuoj në përmirësimin e vetë-qeverisjes lokale në Kosovë

AKK ka organizuar takimin e Kryesisë së Kolegjiumit me 12 prill 2011 dhe ka përgatitur Planin e Punës për vitin 2011 ku në vija të trasha janë përcaktuar:

1. 2 prioritete
2. Objektivat
3. Aktivitetet
4. Datat (muajt) për takimeve gjatë vitit 2011

Plani i Punës është në përputhje me i) fushat strategjike të veprimit në kuadër të Strategjisë së AKK-së 2011-2015, ii) prioritetet e identifikuar në Deklaratën parimore për arsim, iii) prioriteteve të identifikuar për vitin e kaluar 2010 dhe iv) çështjet e ngritura në takimin e Kolegjiumit me 04 shkurt 2011.

Ky Plan i Punës duhet të shihet si një dokument i cili ka nevojë për azhurnim dhe plotësim të vazhdueshëm në mënyrë që t'i përshtatet kërkesave dhe nevojave të komunave të Kosovës sipas situatës në teren.

## Plani Vjetor i Punës për vitin 2011 për Kolegjin për Arsim dhe Kulturë

		Takimi 1 Shkurt	Takimi 2 Prill	Takimi 3 Maj	Takimi 4 Qershor	Takimi 5 Tetor	Takimi 6 Dhjetor
<b>Prioriteti I</b>	<b>Sigurimi i cilesise ne arsim</b>						
<b>Objektiva I. 1</b>	<b>Ngritja e kapaciteteve menaxhuese në shkolla</b>						
Aktiviteti - I.1.1	Trajnimi i drejtorëve të shkollave për menaxhimin e shkollave				X		X
Aktiviteti - I.1.2	Pjesëmarrje në procesin legjislativ për ligjin për arsimin parauniversitar			X			X
<b>Objektiva I. 2</b>	<b>Zhvillimi i kapaciteteve për mësimdhënie</b>						
Aktiviteti - I.2.1	Trajnimi i mësimdhënësve për përdorimin e metodologjive bashkëkohore në mësimdhënie			X			X
Aktiviteti - I.2.2	Monitorimi/vlerësimi i mësimdhënies	- Analiza e suksesit të gjysmë-vjetorit I të vitit shkollor 2010/11 - Provimi shtetëror i maturës	Provimi i maturës				X
Aktiviteti - I.2.3	Plotësimi dhe ndryshimi i udhëzimeve administrative (rekomandime MASHT-it)		- Formula e financimit - Shqyrtimi i urdhëresave administrative				X
<b>Prioriteti II</b>	<b>Infrastruktura shkollore</b>						
<b>Objektiva II. 1</b>	<b>Përmirësimi i kushteve të punës në shkolla</b>						
Aktiviteti - II.1.1	Hartimi/harmonizimi i planeve strategjike zhvillimore komunale për arsim për periudhë 3 vjeçare			X			X

Aktiviteti - II.1.2	Furnizimi me mjete konkretizimi (laboratore, salla të muzikës, shkolla profesionale, etj)					X	X
Aktiviteti - II.1.3	Krijimi i ambientit të shëndetshëm në shkolla (gjelbërim, ujë të pijshëm, salla sportive, rrethoja, etj)					X	X
<b>Objektiva II. 2</b>	<b>Unifikimi i rregulloreve komunale për arsim</b>						
Aktiviteti - II.2.1	Plotësimi dhe ndryshimi i rregulloreve komunale				X		X
<b>Objektiva II. 3</b>	<b>Rrjetizimi i shkollave</b>						
Aktiviteti - II.3.1	Hartimi i kriterëve për ndarjen zonale				X		X
Aktiviteti - II.3.2	Sigurimi i transportit për nxënës					X	X